



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i njohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e 80-të, të mbajtur më 18.01.2023, morri vendimin vijues:

### VENDIM

Denoncimi me numër 12-5339/1 i datës 30.05.2022, HIDHET POSHT.  
KSHPK-ja konstatoi se autoriteti kompetent për trajtimin e denoncimit është Këshilli Gjyqësor i RMV-së.

Denoncimi të dorëzohet për veprim kompetent në Këshillin Gjyqësor të RMV-së.

Lënda me numër 12-5339 të vitit 2022 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimarrjes.

### Arsyetim

Lënda me numër 12-5339/1 të datës 30.05.2022 është formuar në bazë të denoncimit të marrë nga ///. Në denoncim, parashtruesi paraqet pretendime në lidhje me dyshimet për kryerje të pakujdesshme të funksionit gjyqësor nga zyrtarë ///, gjyqtarë të ///, në lidhje me një çështje të së njëjtës gjykatë, të regjistruar nën ///. Nga KSHPK-ja kërkohet ta rishqyrtojë këtë rast në përputhje me kompetencat e saj ligjore. Në shtojcë të denoncimit është dorëzuar edhe aktgjykimi për çështjen e lartpërmendur gjyqësore.

Me mbikëqyrjen e përmbajtjes së denoncimit, KSHPK përcaktoi se në rastin konkret denoncimi nuk përmban elemente për veprimin e saj kompetent. Autoriteti kompetent që është i autorizuar për shqyrtimin e pretendimeve nga denoncimi është Këshilli Gjyqësor i RMV-së, për çka KSHPK-ja parashtruesi duhet t'ia përcjell kërkesën për veprim kompetent këtij autoriteti.

Bazuar në të theksuarën sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Dorëzuar deri:  
Parashtruesi i denoncimit  
- Këshilli Gjyqësor i RMV-së

Përgaditi: Mr D. D.  
Miratoi: K.N.

КОМИСИОНИ ШТЕТЁРОРЁ  
ПЁР ПАРАНДАЛИМИН Е КОРРУПСИОНИТ  
Нёнкрыетар  
Mr. Vlladimir Georgiev

